Shoqata Kosovare e të Shurdhërve
Udruženje Gluvih Kosova
Kosovar Association of the Deaf



BROSHURË INFORMATIVE PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË SHURDHËR

FINNISH ASSOCIATION
OF THE DEAF

SHOQATA KOSOVARE E TË SHURDHËRVE

BROSHURË INFORMATIVE PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË SHURDHËR

Prishtinë, 2014

BROSHURË INFORMATIVE PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE TË SHURDHËR

PËRMBAJTJA:

1. Hyrja

2. Zbatimi i programit për prindërit në SHKSH

3. Rekomandimet nga prindërit për prindërit

4. Shkaqet e Shurdhërisë

5. Kultura e personave të Shurdhër

6. Si të komunikojmë me fëmijët e Shurdhër

7. 10 modele prindërore për fëmijët e Shurdhër

8. Rritja e vetëbesimit tek fëmijët e Shurdhër – 8 këshilla të vlefshme për prindërit

9. Arsimi dygjuhesh (edukimi bilingual)? Roli dhe rendesia?

10. Të drejtat e fëmijëve të Shurdhër

11. Disa shenja për ju

12. Adresa të rëndësishme

Kjo broshurë u përgatit nga autorët:

Selman Hoti – Trajner i interpretëve të gjuhës së shenjave në Shoqatën Kosovare të Shurdhërve
Nikoleta Spahi – Kordinatore e interpretëve të gjuhës së shenjave në Shoqatën Kombëtare Shqiptare të njerëzve që nuk dëgjojnë ANAD
Enver Kurtalani – Dizajni

©SHKSH

HYRJA

Nuk e dimë nëse ka ndonjë fenomen tjetër që rezulton se prindërit që kanë fëmijë të Shurdhër janë të bombarduar me informacione kontradiktore. Në fillim kur të kuptojnë së fëmija është i/e Shurdhër ju do të filloni të bllokoheni dhe filloni të kërkoni ndihmën nga njerëz dhe profesionist por që shpesh këto informacione janë kontradiktore.

Më së shpeshti ndodhë që do ju drejtojnë që të kontaktoni terapist të ndryshëm si audiolog, ose ju kërkojnë që fëmija juaj të bëjë terapi logopedike (që fëmija juaj të mësoj disa fjalë) ose do të ju sugjerojnë që fëmija juaj të bëjë implantin koklear (chochlea implant).

Por herët apo vonë ju do të hasni dhe të kuptoni se ka njerëz dhe organizata (sic është SHKSH) të cilët avokojnë që ndaj këtyre fëmijëve të bëhet një përafrim kulturor dhe mbi bazë të drejtave të njeriut dhe në fund ju kuptoni se fëmija juaj është pjesë e një kulture dhe gjuhe shumë interesante dhe se fëmija juaj mund të bëjë gjithçka përveç se të dëgjojë.

Natyrisht se ka shumë ekspert të cilët punojnë me fëmijë e Shurdhër por JU dhe vetëm JU jeni eksperti më i mirë për fëmijën tuaj. Ju gjithmonë do duhet të bëni zgjedhjen më të mirë për fëmijën tuaj. Çelësi është tek ajo që të gjejmë një metodologji e cila i përshtatet fëmijës tuaj në krahasim me atë që shumica e ekspertëve tradicionalist ofrojnë që detyrimisht fëmija juaj ti përshtatet metodologjisë së tyre.

”Nëse prindërit nuk janë në gjendje të pranojnë faktin se fëmija i tyre është fëmijë i/e Shurdhër dhe vazhdojnë të injorojnë implikimet e shurdhërimit dhe efektet që rezultojnë në fëmijën e tyre janë, inkurajimi i mohimit të autencitetit (atij që është). Pra një fëmijë i tillë është i pamundur ta pranojë veten ashtu sic është, dhe kapaciteti për të dalë nga vetja dhe për të qenë ai që është bllokohet. Ai/ajo jeton me gënjeshtrën egzistenciale dhe është e pamundur që të lidhet me veten e tij dhe me personat tjerë të Shurdhër dhe me botën e vërtet përreth tij”

Stanley Kripnner dhe Harry Easton

1. ZBATIMI I PROGRAMIT TË PRINDËRVE NË SHKSH

SHKSH është e vetmja organizatë në nivelin kombëtar (organizatë ombrellë e 12 Shoqatave Lokale të Shurdhërve në Republikën e Kosovës) në mbrojtje tëtë drejtave të personave të Shurdhër. SHKSH është themeluar në vitin 2007 dhe është e fokusuar në programe të ndryshme specifike duke marrë iniciativa të ndryshme ligjore dhe politika të ndryshme me qëllim të arritjes së barazisë dhe pavarsisë së personave të Shurdhër në shoqëri.

Duke patur parasysh rolin shumë të rëndësishëm që ka familja e sidomos prindërit e fëmijëve të Shurdhër, SHKSH gjatë këtij viti ka organizuar trajnimet bazike për prindërit dhe familjarët, trajnime të cilat janë ofruar nga studentët e Shurdhër të Programit të trajnimeve për Asistent Klase dhe Instruktor të Gjuhës së Shenjave të përkrahur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Shoqatës Finlandeze të Shurdhërve, poashtu SHKSH ka botuar këtë broshurë që sado pak të informojë prindërit lidhur me mënyrën e përafrimit dhe praktikat më të mira të përafrimit dhe kujdesit ndaj fëmijëve të Shurdhër.

SHKSH gjatë gjithë aktiviteteve të saja 7 vjecare ka patur për fokus programet e trajnimt dhe fuqizimit të komunitetit duke përfshirë; trajnimet nëshoqatat lokale të Shurdhërve, trajnimet për të rinjët dhe gratë, trajnimet e interpretëve të gjuhës së shenjave; iniciativat ligjore si; zyrtarizimi i gjuhës së shenjave në Republikën e Kosovës në vitin 2010, programi kombëtarë për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës 2013-2016, Projekt rregullorja për njësinë për ofrimin e gjuhës së shenjave në Republikën e Kosovës; Nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me përkrahjen e projetit për trajnimet e Asistentëve në Klasa dhe Instruktorëve të Gjuhës së Shenjave (program që ka filluar në vitin 2013 dhe po vazhdon) dhe iniciativat tjera ligjore duke përfshirë edhe politikat qeveritare që kanë të bëjnë me të drejtat e komunitetit të Shurdhër siç janë edhe Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2023) dhe Plani i Veprimit për Implementimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2015). Poashtu SHKSH ka në fokus të vecantë edhe prindërit e femijëve të Shudhër dhe familjarëve të tyre.

Shumica e prindërve nëpër botë të cilët kanë fëmijë të Shurdhër, kanë treguar se përkrahja nga prindërit për prindërit që kanë fëmijë të Shurdhër ka qënë shumë e rëndësishme dhe e vlefshme. Poashtu organizimi I aktiviteteve të ndryshme të prindërve dhe ndarja e përvojave mes tyre është një ndër

aktiviteteve më të shpeshta që prindërit organizojnë. Poashtu pjesemarrja në shoqatat lokale të Shurdhërve mund te jetë një përkrahje shumë e madhe.

Gjatë vitit 2014 SHKSH në kuadër të Projektit për Asistent Klase dhe Instruktor të Gjuhës së Shenjave ka organizuar trajnime bazike për gjuhën e shenjave ku të pranishëm kanë qenë edhe prindërit e fëmijëve të Shurdhër.

Qëllimi këtyre trajnimeve ka qënë:

Informimi i prindërve në lidhje me infomacione bazë dhe shumë të rëndësishme rreth kulturës së Shurdhërve , me komunikimin baze në gjuhën e shenjave, mësimin e formave të dorës për secilën shkronjë daktile, mësimin e daktilimit të gjuhës së shenjave shqipe dhe praktikimin e tyre.

2. REKOMANDIME NGA PRINDERIT PER PRINDERIT

Të kujdesesh për fëmijën e Shurdhër është e njëjtë por edhe ndryshe sikurse të kujdesesesh për fëmijët tjerë. Aty ku janë ndryshimet aty dalin edhe vështërsitë dhe përkrahja dhe këshillimi nga prindërit tjerë janë shumë të rëndësishme. Informacionet e mëposhtshme janë këshilla nga prindërit të cilët kanë fëmijë të Shurdhër.

Komunikimi

Komunikimi është aspekti me i rëndësishëm i jetës në familje. Shpeshherë ne e kemi të vështirë të kuptojmë se cila mënyrë e komunikimit është më e përshtatshëm për fëmijët tanë. Por prindërit janë ata të cilët më së miri I kuptojnë fëmijët e tyre. Për më shumë shih informacionet në kapitullin 5.

Zgjedhja dhe dëshirat e fëmijëve

Mundohuni që të gjeni një mënyrë adekuate për të kuptuar dëshirat dhe zgjedhjet e fëmijes suaj p.sh se çfare lodër, kukull fëmija juaj preferon dhe këtë mund të arrini duke ofruar fëmijës tuaj një mori fottosh ose vizatimesh, përpiquni të kaloni sa më shumë kohë me fëmijën tuaj.

Kujdesi

Kujdesi paraqet problem dhe është një fushe shumë komplekse.

Prindërit të cilët kanë fëmijë të Shurdhër shpesh hasin në probleme të ndryshme sa I përket sigurisë dhe secili prindër e di se sa është e rëndësishme që të edukojnë fëmijët e tyre lidhur me sigurinë duke filluar nga siguria në rrugë, shoqëri.

Emocionet

Është shumë me rëndësi që fëmija juaj të përcjell emocionet tek ju. Pengesat e komunikimit shpeshherë është barrier që prindërit të kuptojnë emocionet e femijëve të tyre të Shurdhër. Pra, prindërit duhet të gjejnë mënyrat dhe strategjitë e tyre për të diskutuar emocionet e fëmijëve të tyre duke përdorur histori të ndryshme dhe libra (duke përdorur gjestet, shprehjet faciale dhe duke u siguruar që të pasurojnë fjalorin e tyre të gjuhës së shenjave në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë emocionet e fëmijëve të tyre).

Pavarësia

Pavarësia nënkupton gjëra të ndryshme për fëmijë të ndryshëm. Kjo mund të nënkuptojë që prindërit të mësojnë fëmijët e tyre të ushqehen vet, tëvishen ashtu siç ata dëshirojnë ose të udhëtojnë vet. Për prindërit shpeshherë është sfidë që të lejojnë fëmijët e tyre të zhvillojnë pavarësinë e tyre. Rrugëtimi drejt të panjohurës mund të jetë e frikshme edhe për prindërit por edhe për fëmijët. Pra prindërit duhet të jenë promovues të zhvillimit dhe përkrahjes së pavarësisë së fëmijëve të tyre.

Gjeni pak kohë edhe për veten

Në shumicën e rasteve prindërit të cilët kanë fëmijë të Shurdhër ndjejnë mungesën e kohës së lirë për veten e tyre, prandaj ata duhet të ndajnë pak kohë të lirë për vete dhe relaksim. Me këtë do të ndihmoni edhe femijën tuaj që të mos jetë shumë i varur nga ju.

Lejoni fëmijën tuaj të jetë ai që është !

Kjo është një ndër aspektet kritike për të lejuar fëmijën tuaj që të bëjë zgjedhjen më të mirë. Kjo do tu japë më shumë liri fëmijës tuaj të jetë ai që do të jetë. Nuk ka shumë rëndësi nësë fëmija juaj njeh rrjedhshëm gjuhën e shenjave, nuk është me rëndësi që fëmija juaj përdor daktilen apo të folurën si mjet komunikimi, nuk është e rëndësishme nësë fëmija juaj ndjek shkollën për të Shurdhërit, nuk

është e rëndësishme nësë fëmija juaj ndjek shkollën e zakonshme, nuk është me rëndësi nëse fëmija juaj është person i/e Shurdhër apo pjesërisht dëgjon, por gjëja më e rëndësishme dhe më e drejtë është; cfarëdo që funksionon për fëmijën tuaj, fëmija juaj duhet ta di se ju jeni përkrah tyre.

3. SHKAQET E SHURDHËRISË

Ka shumë arsye se pse një fëmijë mund të jetë i lindur i Shurdhër apo të bëhet i shurdhër në fëmijërinë e hershme. Jo gjithmonë është e mundur që të zbulohen shkaktarët e shurdhërsisë. Ky seksion liston disa arsye të shurdhërisë të cilat kanë shkaktarë të përbashkëta.

Shkaqet para lindjes (shkaqet para-natale)

Shumë fëmijë lindin të Shurdhër për shkak të një arsye gjenetike. Një familje mund të ketë fëmijë të Shurdhër edhe pse nuk ka asnjë histori familjare të Shurdhimit. Ndonjëherë ky gjen i përfshirë mund të shkaktojë edhe aftësi të kufizuara të tjera shtesë ose probleme shëndetësore.

Shurdhimi mund të shkaktohet edhe gjatë komplikacioneve gjatë shtatzanisë. Sëmundje të tilla si të rubeolës citomegalovirusit (CMV) toksplamozes, dhe herpes mund të shkaktojë që një fëmijë të lind i Shurdhër. Egzistojnë edhe një varg barnash të cilët mund të dëmtojnë sistemin e dëgjimit të një foshnje para lindjes

Shkaqet pas lindjes (shkaqet post–natale)

Sikurse tek shkaqet para-natale edhe edhe shkaqet në fazën post-natale mund të rrisin rrezikun për shurdhërimin e një fëmije. Lindja e parakohshme rrit rrezikun që një fëmijë të lind i Shurdhër apo të bëhen të Shurdhër. Fëmijët e lindur para kohe janë të rrezikuar dhe të prirur ndaj infeksioneve të ndryshme që mund të shkaktojnë Shurdhimin. Ata mund të jënë të lindur me verdhëz të rëndë apo mungesë oksigjeni, të dyja këto të cilat mund të shkaktojnë Shurdhimin apo humbjen e dëgjimit.

Poashtu ka një varg sëmundjesh që në fëmijërinë e hershme mund të shkaktojnë shurdhimin e një fëmije. Sëmundjet si meningjiti, fruthi dhe shyta mund të jenë shkaktare të shurdhimit apo humbjes së dëgjimit.

Poashtu ka një varg sëmundjesh që në fëmijërinë e hershme mund të shkaktojnë shurdhimin e një fëmije. Sëmundjet si meningjiti, fruthi dhe shyta mund të jenë shkaktare të shurdhimit apo humbjes së dëgjimit.

Në raste të rralla shurdhimi mund të shkaktohet nga lëndimi në kokë apo ekspozimi në zhurmë me zë të lartë. Këto mund të dëmtojnë sistemin e dëgjimit.

4. KULTURA E PERSONAVE TË SHURDHËR

Kultura e personave të Shurdhër përshkruan besimet, sjelljet sociale, artin, traditat letrare, historinë, vlerat dhe institucionet e përbashkëta të komuniteteve që janë të prekur nga shurdhësia dhe që përdorin gjuhën e shenjave si mjet kryesor të komunikimit.

Anëtarët e komunitetit të Shurdhër priren për të parë shurdhërinë si një ndryshim të përvojës njerëzore dhe jo paaftësi.

Komuniteti mund të përfshijë anëtarët e familjes të personave që nuk dëgjojnë interpretët të cilët identifikohen me kulturën e njerezve qe nuk degjojne . Ashtu si me të gjitha grupet sociale që një person zgjedh të përkasin, një person është një anëtar i komunitetit të njerëzve që nuk dëgjojnë nëse ai ose ajo "identifikon atë / veten si një anëtar i komunitetit të njerezve qe nuk degjojnë , dhe anëtarë të tjerë të pranojë atë person si pjesë e komuniteti ".

Kultura e njerezve qe nuk degjojne është njohur në bazë të nenit 30, paragrafi 4 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, i cili thotë se: "Personat me aftësi të kufizuara do të kenë të drejtë, në baza të barabarta me të tjerët, për njohjen dhe mbështetjen e kulturore të tyre specifike dhe gjuhësor, duke përfshirë edhe gjuhën e shenjave dhe kulturën e të shurdhërve.

5. SI TË KOMUNIKOJMË ME NJË FËMIJË TË SHURDHËR?

1

Mbani mend që fëmija I Shurdhër është si fëmijët e tjerë, ata duan të ndërveprojnë me të riturit, të marrin dhe japin infomacione dhe të tërheqin vëmendjen tuaj. Perpiquni të kini durim, të mos nervozoheni gjatë komunikimit me një fëmijë të Shurdhër.

2

Gjestet flasin shume, ju nuk duhet të dini shumë mirë të gjitha shenjat (edhe pse do të ishte shumë e rëndësishme) për të arritur qëllimin e komunikimit tuaj. Referimi, pantomima dhe përdorimi i shrehjeve të fytyrës janë të mjaftueshme.

3

Mësoni disa shenja të përditshme të cilat janë më shpesh të përdorura. Thjesht disa shenja ju ndihmojnë shumë. Fokusohuni më shumë në shenjat rreth familjes, ushqimeve, ndjenjave dhe nevojave të fëmijës tuaj.

4

Sigurohuni që keni vëmendjen e fëmijes tuaj perpara se ju të filloni të komunikoni. Një mënyre e mirë për të tërhequr me kujdes vëmendjen e femijës është ta prekësh pak tek supi ose t'ja bësh me dorë, por jo direkt në fytyrë . Ashtu sikurse të gjithë fëmijët e tjerë, femijët e Shurdhër mund të shpërqëndrohen shpejt, kështu që siguroju se ai/ajo po ju shikon në momentin që ju po komunikoni me të dhe përpiquni të mbani vëmendjen e ti/sajj deri në fund të bisedës.

5

Shikoni me kujdes fëmijën i cili bisedon me ju, dhe përpiquni të kuptoni atë që ai po bën me shenja. Nëse ju nuk e kuptoni, kërkojini atij/asaj të përsitë përsëri informacionin e dhënë, të daktilojë ose bëjë shenjat me ngadalë në mënyrë që ju ta kuptoni qartë.

6

Zakonisht motra apo vëllai që dëgjojnë në shtëpi mund të intërpretojë për një fëmijë të Shurdhër kur është e nevojshme(për të tjërët). Megjithatë, përdoreni ketë si një mundësi por duhet ta dini se fëmija do të flasë direkt me ju, por edhe sepse motrat dhe vellezerit bezdisen duke përkthyer gjithcka gjatë gjithë kohës .

SHKSH inkurajon prindërit që të mësojnë gjuhën e shenjave në mënyrë që të kuptojnë nevojat e fëmijeve të tyre.



6. 10 MODELE PRINDËRORE PËR FËMIJËT E SHURDHËR

1. Ndjehuni rehat mes fëmijëve të Shurdhër

Një fëmijë i Shurdhër mund të arrijë të integrohet plotësisht në shoqëri nëse të rriturit qe e rrethojnë e ndihmojnë për këtë. Fëmijët e Shurdhër kanë nevojë të marrin informacion rreth shurdhësisë

2. Këto janë disa gjëra që ju duhet ti bëni

- Të jeni pjesë e aktiviteteve ku fëmijët shkojnë.
- Të shohin/mësojnë nga personat e Shurdhër të rritur si modele.
- Të shkojnë në aktivitete të personave të Shurdhër së bashku me femijët e tyre.

3. Bëhuni pjesë e Shoqatës së të Shurdhërve (në qytetin ku jetoni), ose grupimevë të prindërve

Të ndihmon shumë të takosh dhe të japësh këshilla edhe për prindër të tjerë. Të ndihmon të ndash të njëjtat eksperienca. Nga studime të ndryshme ka rezultuar se prindërit e fëmijëve të Shurdhër kanë një nevojë të madhe të grupohen me prindër të tjerë rreth problematikave që ata i shqetësojnë.

4. Bisedo me prindërit e tjerë rreth problemeve të fëmijëve

Forconi komunitetin e prindërve të fëmijëve të Shurdhër në qytetin ku ju jetoni duke ndikuar në këtë mënyrë pozitivisht për të ardhmen e fëmijëve tuaj.



5. Përfshihuni në aktivitete shkollore

Prindër të ndryshëm e kane theksuar këtë fakt si shumë të rëndësishëm.

6. Përsëriti gjithçka fëmijës.

Përpiqu ti shpjegosh fëmijës deri në hollësi, mos përdor shprehjen “ta them pastaj“ Familjet e sukseshme janë ato familje ku komunikimi qoftë ai oral apo me shenja është gjithnjë i pranishëm mes tyre.



7. Inkurajo gjithpërfshirjen

Fëmijët e Shurdhër shpesh ndihen të përjashtuar nga bisedat e ndryshme të cilat zhvillohen në shtëpi . Përpiquni ti përfshini fëmijët gjatë bisedave familjare sepse kur ata të rriten asnjëhere nuk mund t'ju kuptojne ju.
Nëse ju I përjashtoni nga bisedat apo ndërveprimet, mendoni se cfarë do të ndodhë me fëmijën tuaj në shoqëri?

8. Bëhu realist por dhe ambicioz për fëmijën tënd

Një ushtrim I shkurtër konsultimi me prindërit rezultoi se pritshmëritë e mësuesve për fëmijën e Shurdhër ishin të ulta, ndërsa pritshmëritë e prindërve ishin shumë të larta.
Motivojini fëmijët tuaj të ecin përpara.

9. Ndihmoje fëmijën sipas mundësive

Mos kërkoni nga fëmijët vetëm punë të "sigurta" (financiarisht) sepse në të vërtet nuk funksionon por lejoni fëmijën tuaj që të kërkojë dhe provojë mundësi të reja punësimi sipas dëshirës së tij/saj.

10. Inkurajo hobit dhe interesat e tyre.

Të rinjtë e Shurdhër shpeshherë ankohen nga mbi mbrojtja dhe mbi kujdesi nga ana e prindërve të tyre. Inkurajoni fëmijën tuaj dhe mbështesni interest dhe iniciativat e ndryshme që ata duan të ndërmarrin.

Jepjuni atyre një shans për veten.



7. RRITJA E VETBESIMIT TEK FËMIJËT E SHURDHËR (8 KËSHILLA PËR PRINDËRIT)

"8 Këshilla për Nxitjen e vetëbesimit në fëmijët e Shurdhër ose me vështirësi dëgjimi "nga Paula Rosenthal, J.D.

1. Lëre fëmijën të shprehet. Lejoni fëmijën të flaës për vete sa më shpesh që është e mundur edhe në qoftëse gjuha e tij është e kufizuar. Bëhu i/e durueshëm dhe dëgjoni me vëmendje. Duke bërë këtë ju keni mundësi që lehtësisht të vlerësoni se cfarë fëmija dëshiron apo ka nevojë dhe vlerësoni se ai është I aftë të komunikojë për vete. Ju në këtë rast do të demonstroni aftësi të rëndësishme të vëmendjes, të dëgjuarit dhe bashkëvepruarit me fëmijën.

2. Silluni njëlloj me fëmijët në familje, pra silluni njëlloj si me fëmijën e Shurdhër poashtu edhe me fëmijën që dëgjon gjatë gjithë kohës. Fëmijët janë shumë të ndjeshëm andaj asnjëherë mos përdorin humbjen e dëgjimit të fëmijës si justifikim për ndonjë veprim apo sjellje të papërshtatshme.

3. Mësojini fëmijët se si të sillen. Mësojini fëmijës tuaj të krijojë lidhje, shoqërim me fëmijët tjerë qysh në moshën e vogël, sigurohu që aim und dhe duhet të prezantojë veten dhe të kërkojë nga të tjerët të prezantohen. Mësojini ata se sit ë kontaktojnë me bashkëmoshatërët e tyre. Duke përgatitur fëmijën tuaj, ai/ajo do të ndihet rehat gjatë krijimit të miqve të rinj. Kjo është një aftësi e rëndësishme që do të shërbejë personalisht por edhe profesionalisht gjatë gjithë jetës së tij/saj.

4. Tregojini fëmijës në lidhje me humbjen e dëgjimit në mënyrë që ai/ajo të jetë në gjendje të kuptojë dhe pastaj shpjegojë lidhur me humbjen e dëgjimit, apo pse ka vendosur aparat dëgjimi apo cochlear implant. Le tu tregojë paisjet që ai/ajo përdorë fëmijëve tjerë. Fëmija juaj duhet të jetë krenar për ato që përdorin dhe janë pjesë e domosdoshme e jetës së tyre. Duke marrë pjesë në aktivitetet me moshatarët e tij/saj, fëmija juaj do të jetë I aftë për të përcaktuar mënyrën se cfarë ai pret që të tjerët ta trajtojnë.

5. zbulo se cilat janë interest e fëmijës tuaj dhe zhvillojini ato. Prezantoni fëmijën në një sërë aktivitetesh për të zbuluar atë që ai kërkon. Ndihmojeni fëmijën tuaj që të kultivojë intereimin e tyre duke ndjekur kurse duke u bashkuar në shoqëri/klube apo duke marrë pjesë na aktivitete të ndryshme sa më shpesh që

është e mundur. Kjo mund të përfshijë atletikë, vallëzim, shkrim letrar, art, fotografi, gatim etj. Vetëbesimi I fëmijës tuaj do të rritet së tepërmi kur ai/ajo mëson një aftësi të. Ju dhe fëmija juaj do të jeni krenar për arritjet e tij/saj.

6. Shmangni etiketimin. Mos përdorni humbjen e dëgjimit të fëmijës si një term përshkrues nëse është e nevojshme për diskutim. Disa fëmijë dhe prindërit e tyre mund të ndihen të ofenduar kur shohin se të tjerët i etiketojnë sipas aftësive të tyre.

7. mësojini fëmijës vetë-pranimin. Mos I fshihni aparatet e dëgjimit (nëse fëmija juaj bart ato) ose cochlea implantin. Bëni këto paisje pjesë të natyrshme të jetës së përditshme të fëmijës. Nëse ju provoni që të fshehni/mbuloni

8. Pranoni edhe suksesin dhe përpjekjet për sukses. Një nga mënyrat më të mira për të rritur vetëbesimin e fëmijës tuaj është që të pranojmë përpjekjet e tij akademike dhe sociale nëse ata janë të suksesshëm apo jo. Duke bërë këtë, ju jeni duke treguar atë që dashuria juaj është e pakushtëzuar dhe jo bazuar në rezultatin e përpjekjeve të tij. Motivimi për të provoni nuk duhet të jenë të frymëzuar nga mundësia e një shpërblimi nga prindi apo mësuesi. Oferta falënderim fëmijës jo, para ose dhurata, për të dy përpjekjet e tij dhe arritjet e tij.Në këtë mënyrë, fëmija nuk do të mendojnë se ai e meriton lëvdata apo dashuri vetëm kur ai kryen atë që ai është përcaktuar për të bërë. Fëmijët me humbjen e dëgjimit shpesh përballen me pengesa të shumta duke u rritur. Zhvillimi i hershëm i vetë-respekt, vetë-besimit dhe vetë-pranimit janë të rëndësishëm në suksesin e tyre. Përdorni këto këshilla në shtëpi dhe ta ndani kete informacion edhe me profesionistëve të cilët punojnë me fëmijën tuaj. Së bashku ju mund të siguroni një të ardhme të ndritshme, të sigurt për fëmijën tuaj.



9. TË DREJTAT E FËMIJËVE TË SHURDHËR

Pavarësisht dy konventave të KB për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëvë dhe shumë ligjeve nëpër shtete të ndryshme, shumica e fëmijëve të Shurdhër ende u mohohet e drejta e tyre si në arsim, shëndetësi, jetesa në familje dhe mbrojtja nga abuzimi.

Të drejtat e fëmijëve janë të përcaktuara në mënyra të ndryshma, duke përfshirë një spektëe të të drejtave civile, kulturore, ekonomike dhe politike.

Kujdesi

Fëmijët e Shurdhër, ashtu edhe si të gjithë fëmijët tjerë kanë të drejtë për një standard adekuat të jetesës, kujdesit shëndetësor, edukimit dhe shërbimeve për lojë dhe rekreacion. Këto përfshijnë një diet/vakt të ekuibluar, një shtrat të ngrohtë për të fjetur dhe qasje në shkollim

- Sikurse të gjithë fëmijët tjerë, edhe fëmijët e Shurdhër kanë të drejtë të kenë qasje të plotë në edukim cilësor.
- Fëmijët e Shurdhër mësojnë më së miri nëpërmjet modaliteteve vizuale dhe varen nga gjuha e shenjave.
- Truri pa stimulim adekuat në moshën kritike të të nxënit 0-3 vjeç mund të përvetësoj shumë sidomos në të nxënit të gjuhës. Mirëpo në mungesë të përkrahjes familjare dhe shërbimeve të ofruara nga komuniteti fëmijët e shurdhër janë të zvarritur pa nevojë në përvetësimin e gjuhës së shenjave derisa ata të fillojnë shkollën.
- Gjuha e shenjave është një mjet shumë i vlefshëm gjuhësor për të përcjellë mendimet, idetë dhe emocionet.



Mbrojtja

Fëmijët e Shurdhër sikurse fëmijët tjerë kanë të drejtë të mbrohen nga abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe diskriminimi. Kjo përfshin vende të sigurta për fëmijët për të luajtur, qëndrim konstruktiv në rritjen e fëmijës dhe njohjen e kapacitetit të zhvillimit të fëmijëve të Shurdhër.

Pjesëmarrja

Fëmijët e Shurdhër kanë të drejtë të marrin pjesë në komunitetin e tyre, të kenë programe dhe shërbime për ta. Kjo nënkupton pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e komunitetit të Shurdhër, të dëgjohet "zëri" tyre në komunitet dhe të jenë pjesë e vendim-marrjes në komunitetin e tyre.

10. ARSIMI DYGJUHËSH (BILINGUAL)

Arsimi dygjuhësh (bilingual) është një qasje për fëmijët e Shurdhër të cilët nëpërmjet gjuhës së shenjave (si gjuhë amtare) mësojnë edhe gjuhën e shkruar nacionale, në këtë rast gjuhën e shkruar shqipe.

Qëllimi i edukimit dyhjuhësor:

- Për të mundësuar fëmijëve të Shurdhër kompetencat gjuhësore
- Për të siguruar qasje në një kurikul të gjërë
- Për të lehtësuar aftësi të mira leximi
- Për të siguruar nxënësit e Shurdhër me një ndjenjë pozitive të identitetit të tyre

Personat e Shurdhër bilingual janë më të mirë në:

- Mësim në përgjithësi
- Në të menduarit kompleks dhe kreativ
- Aftësi interpersonale dhe komunikative
- Zvogëlon vonesat e zhvillimit mendor sic janë: alzheimer, dementia



11. GJUHA E SHENJAVE KOSOVARE (GJSHK)


Gjuha e shenjave është gjuha e parë për personat e Shurdhër. Ka shumë kohë që është vërtetuar që gjuhët e shenjave janë gjuhë reale. Shumë studeime të bëra kanë vënë në pah se gjuhët e shenjave kanë strukturat e tyre fonologjike tëcilat përfshijnë formën e dorës, vend-ndodhjen, lëvizjet dhe tiparet jomanuale. Poashtu në bazë të hulumtimeve të gjuhëve të shenjave nëpër botë tregojnë se këto gjuhë kanë të njëjtat nivele të organizimit gjuhësor, ashtu si gjuhët e folura që kanë rrafshin fonemik, morfologjik, sintaksor dhe të diskursit (Klima dhe Bellugi, 1979: Petitto 2000).

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve ka botuar fjalorin e parë Gjuha e Shenjave Kosovare 1 dhe DVD e cila përveq përshkrimit të shenjave përmban edhe 50 fjali në Gjuhën e Shenjave Kosovare të përkthyera në gjuhën shqipe.

Të gjithë prindërit ose familjarët e interesuar që të kenë një kopje të këtij fjalori dhe DVD mund të kontaktojnë Shoqatën Kosovare të Shurdhërve dhe të kenë një kopje. Fjalori dhe DVD jipen falas.




12. Alfabeti daktil




13. Disa shenja per ju!




familje,~a *f.*



prind,~i *m.*




1. **gjysh,~i** *m.*
2. **vjetër i,e** *mb.*
3. **plak,~u** *m.* **plak/ë,~a** *f.*




1. **gjysh/e,~ja** *f.*
2. **pop,~i** *m.* (ortodoks) **prift,~i** *m.*




1. **baba,~i** *m*.
2. **burr/ë,~i** *m*.



nën/ë,~a *f*.




foshnj/ë,~a, *f*. *sin* **beb/e,~ja** *f*.



binjak,~e *mb*.




1. **fëmij/ë,~a** *m.*
2. **nip,~i** *m.* **mbes/ë,~a** *f.*




1. **djal/ë,~i** *m.*
2. **mashkull,~i** *m.*




1. **vajz/ë,~a** *f. sin.* **goc/ë,~a** *f.* **çup/ë,~a** *f.*:**çikë,~a** *f.*
2. **fem/ër,~ra** *f.*




1. **vëlla,~i** *m.*
2. **mot/ër,~ra** *f.*
3. **njësoj**, *ndajf. sin.* **njëlloj**




1. **mot/ër,~ra** *f.*
2. **patjetër** *ndajf.*




1. **martes/ë,~a** *f.*
2. **burr/ë,~i** *m.*
3. **bashkëshort,~i** *m.*
4. **bashkëshort/e,~ja** *f.*



grua,-ja *f.*




shtëpi,~i *m.*




banes/ë,~a *f.*




1. **zil/e,~ja** *f.*
2. **ashensor,~i** *m.*




korridor,~i *m.*




der/ë,~a *f.*




dritar/e,~ja *f.*




shtrat dysh



dollap,~i *m.*




1. **kuzhin/ë,~a** *f.*
2. **gatim,~i** *m.*
3. **përzierj/e,~a** *f.*




pjat/ë,~a *f.*



1. **lug/ë,~a** *f.*
2. **ha me lugë**



pirun,~i *m.*



got/ë,~a *f.*

Adresa me rëndësi

Shoqata e të Shurdhërve në Prishtinë
Adresa: Rr. 2 Korriku Nr 10/12
Prishtinë 10000
Email: sh.shurdherve_pr@hotmail.com
Tel: 044 899 167 (vetem sms)

Shoqata Rajonale e të Shurdhërve në Prizren
Adresa: Rr. Ismet Jashari Nr. 54
Prizren 20000
Email:
Tel: 044 351 661

Shoqata e të Shurdhërve në Pejë
Adresa: Rr. Shehi i Haxhi Zekës Nr 10
Pejë 30000
Email: shshpeje@hotmail.com
Tel: 049 421 721 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve në Podujevë
Adresa: Rr. Skënderbeu PN
Podujevë 11000
Email:
Tel: 044 319 287

Shoqata e të Shurdhërve në Mitrovicë
Adresa: Rr. Arta PN
Mitrovicë 40000
Email:
Tel: 049 581 150 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve në Malishevë
Adresa: Rr. Hamdi Berisha, PN
Malishevë 24000
Email
Tel: 045 873 813 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve në Gjakovë
Adresa: Rr. Anton Cetta Nr 2
Gjakovë 50000
Email:
Tel: 044 670 819 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve në Vushtrri
Adresa: Rr. Dëshmorët e Kombit PN
Vushtrri 42000
Email: shshvushtrri@gmail.com
Tel: 044 767 904 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve në Suharekë
Adresa: Rr. Ballkanit PN
Suharekë 23000
Email:
Tel: 049 538 336 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve në Ferizaj
Adresa: Rr. Dëshmorët e Kombit PN
Ferizaj 70000
Email:
Tel: 049 488 349 (vetem sms)

Shoqata e të Shurdhërve Anamorava në Gjilan
Adresa: Rr. Gjon Sereqi Nr. 10/22
Gjilan 60000
Email: shshagjilann@gmail.com
Tel: 044 866 330

Shoqata e të Shurdhërve në Drenas
Adresa: Rr. Barakat e Administratës së Kuvendit Komunal Nr 16
Drenas 13000
Email:
Tel: 045 402 932 (vetem sms)

Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim 'Nënë Tereza' në Prizren
Adresa: Hoxhë Tasini, 231, 20000 Prizren
Personi kontaktues: Yrmet Shabani, Drejtor
Gmail: q.b.nenetereza.pz@gmail.com yrmet77@gmail.com
Facebook: q.b.nenetereza.pz@hotmail.com
Tel: 029/223-628 ose 029/231-211
Mob: +377-44/318-362



Shoqata Kosovare e të Shurdhërve
Adresa: Nazim Gafurri, 28/2-1 10000 Prishtië
PO Box 342
Gmail: deafkosovar@gmail.com
Facebook: SHKSH KAD & SHKSHSR KADYS
Mob: +377/44 655 503 (vetëm sms)
+377/44 185 178
Web: www.shksh.org